

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 05/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 1 korrik 2006 – 4 gusht 2006

Titujt kryesor

- Kuvendi diskuton lidhur me raportin për punën 100 ditore të Qeverisë
- Kuvendi diskuton raportin e Kryesisë lidhur me Qendrën administrativo-protokollare në parkun e Gërmisë
- Kuvendi miraton Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe e miraton në parim projektligjin për trashëgiminë kulturore
- Kuvendi emëron drejtorin e Agjencisë kundër korrupsionit, anëtarin e pestë të Këshillit të KPM-së, dhe zëvendësministrin e drejtësisë

1. Sfond

Raporti i dyzeteshtatë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së III-të të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005, dhe të amendamentuar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 (shiko “Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Punës së Kuvendit”).

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur dy seanca plenare të rregullta, më 13, 14, dhe 17 dhe 27-28 korrik si dhe katër mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 6 korrik, 11 korrik, 19 korrik dhe 31 korrik. Tetë komisione, si dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.¹ Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 15 prej 21 mbledhjeve të komisioneve, një mbledhje të nënkomisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike dhe një dëgjim publik.²

¹ Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 3, 18 dhe 25 korrik derisa komisioni për shëndetësi, punë, mireqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 4, 11, 18, 25 dhe 27 korrik. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 5, 19 dhe 24 korrik derisa komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 4, 11 dhe 25 korrik. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 10, 26 dhe 28 korrik derisa Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 19 dhe 26 korrik. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 11 dhe 18 korrik derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 21 korrik. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe parashtrësia dhe ankesa publike është takuar më 12 korrik. shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur një dëgjim publik të projektligjit për trashëgiminë kulturore më 28 korrik.

² Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 3, 18 dhe 25 korrik; Komisioni për shëndetësi, punë, mireqenie sociale dhe persona të zhdukur më 4, 11, 18, 25 dhe 27 korrik; Komisioni për buxhet dhe financa më 5, 19 dhe 24 korrik; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 4 dhe 11 korrik; Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese më 10, 26 dhe 28 korrik; Komisioni për gatishmëri emergjente më 26 korrik; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 11 korrik; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 21 korrik; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe parashtrësia dhe ankesa publike më 12 korrik; dhe Dëgjimin publik të projektligjit për trashëgiminë kulturore më 28 korrik.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 13, 14 dhe 17 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) më 13 korrik dhe deri në pauzë më 14 korrik dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK) pas pauzës më 14 korrik. Më 17 korrik seanca është kryesuar nga z. Naim Maloku deri në pauzë dhe nga Kryetari i Kuvendit pas pauzës.

- Tetëdhjetë e katër, 85 dhe 76 deputetë ishin të pranishëm në seancë plenare më 13, 14 përkatësisht 17 korrik.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 13, 14 dhe 17 korrikut:
 - Pyetjet për Qeverinë
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për liritë fetare dhe statusin juridik të bashkësive fetare (Projektligji është miratuar me 57 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë (Projektligji është miratuar me 58 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e Ligjit 2003/07 për materialin arkivor dhe arkivat (Projektligji është miratuar me 55 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e Ligjit 2004/12 për standardizim (Projektligji është miratuar me 61 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Diskutimi i raportit 100 ditor të punës së Qeverisë (Kryeministri Agim Çeku (AAK) ka bërë prezantimin e raportit që është pasuar me debat plenar dhe përgjigje të Kryeministrit.)
 - Diskutimi i raportit të Kryesisë lidhur me Qendrën administrativo-protokollare në parkun e Gërmisë (Z. Naim Maloku (AAK) ka bërë prezantimin e raportit që është pasuar me debat plenar dhe miratimin e rekomandimeve të Kryesisë, që kanë marrë 52 vota për dhe 18 vota kundër.)
 - Diskutimi i projektregullores për emërimin e anëtarit të pestë të Këshillit të KPM-së (Projektregullorja është miratuar me 57 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Diskutimi i rekomandimeve për emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër korrupsionit (Emërimi i drejtorit të agjencisë⁴ është bërë me votim të fshehtë me 57 vota për.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27-28 korrik e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Shtatëdhjetë e nëntë dhe 74 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 27, përkatësisht 28 korrik.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27-28 korrikut:
 - Pyetjet për Qeverinë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për trashëgiminë kulturore (Projektligji është miratuar në parim me 58 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e Ligjit 2004/5 mbi tregtinë me naftë dhe produkte të naftës (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për zonat e lira industriale (Projektligji i është kthyer Qeverisë. Shiko pjesën e titulluar “Rendi i ditës”).
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për parqet nacionale

³ Këto janë shifrat e dhëna nga Kryetari i Kuvendit ose Kryesuesi në fillim të secilës ditë të seancës, përveç nëse në këtë raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër.

⁴ Kuvendi e ka emëruar z. Hasan Preteni për drejtor të Agjencisë kundër korrupsionit. Z. Preteni ka përgatitje profesionale ushtarake dhe juridike. Ai ka shërbyer në armatën jugosllave prej vitit 1979 deri më 1991, në UÇK prej mesit të vitit 1998 deri në mes të vitit 1999, dhe në TMK prej mesit të vitit 1999 deri më 2006 si Shef i shtabit të zonës së IV-të të TMK-së në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica me gradën Kolonel.

- (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin
(Projektligji është shtyrë. Shiko pjesën e titulluar “Rendi i ditës”.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për përdorimin e gjuhëve
(Projektligji është miratuar me 52 vota për dhe 13 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarit të pestë të këshillit të KPM-së
(Kuvendi e ka emëruar anëtarin e pestë të Këshillit të KPM-së me 42 vota për. Shiko pjesën e titulluar “Emërimi i anëtarit të pestë të Këshillit të KPM-së”.)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryesuesit të Bordit të Rregullatorit të Energjisë
(Propozimi është miratuar me 50 vota për dhe dhjetë vota kundër.)
- Emërimi i zëvendësministrit të drejtësisë
(Zëvendësministri është emëruar me 34 vota për dhe 32 vota kundër. Shiko pjesën e titulluar “Emërimi i zëvendësministrave”.)
- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion lidhur me raportin e punës për vitin 2005 të Agjencisë së Rregullatorit të Telekomunikacionit (ART)
(Kjo pikë është shtyrë. Shiko pjesën e titulluar “Rendi i ditës”.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

Në fillim të seancës plenare të 27 korrikut, z. Alush Gashi propozoi në emër të LDK-së që shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin të shtyhej në mënyrë që t'i mundësohej komisionit funksional dhe Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale t'i harmonizojnë amendamentet e tyre dhe ai poashtu e mbështeti propozimin e Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion, që ishte dorëzuar me shkrim para seancës, për kthimin e projektligjit për zonat e lira industriale në Qeveri për shqyrtim të mëtejshëm. Znj. Gjylnaze Syla (AAK) paraqiti vërejtjen se në rendin e ditës nuk ishin përfshirë dy propozimet⁵ e grupit të saj parlamentar – hartimi i Kushtetutës së Kosovës dhe miratimi i një rezolute për diasporën – duke insistuar që sipas rregullës 6.5 të dy propozimet ishin dashur të përfshihen në seancën plenare të asaj dite. Kryesuesi e ftoi Kuvendin që t'i votonte një nga një propozimet e bëra nga z. Gashi dhe nga Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion, të cilat janë miratuar me shumicë votash për. Në përgjigje ndaj znj. Syla, Kryesuesi deklaroi se “Kryesia e ka trajtuar kërkesën e AAK-së rreth një rezolute dhe nuk e ka vënë në rend dite për këtë seancë, dhe ka sugjeru që shifat e grupeve parlamentare të merren vesh për këtë çështje.” Znj. Syla e përsëriti se propozimet e grupit të saj parlamentar duhet të përfshiheshin në rendin e ditës në pajtim me Rregulloren e Kuvendit. Kryesuesi menjëherë e ftoi Kuvendin të votojë “kush është që të hyjë në rend dite një rezolutë të cilën s’e kemi në dorë askush dhe që s’ka objekt diskutimi.” Asnjë deputet nuk e ka ngritur dorën në mënyrë të dukshme, qoftë kur Kryesuesi ka thirrur kush është për qoftë kur ka thirrur kush është kundër. Objekti i votimit nuk ishte i qartë meqë grupi parlamentar i AAK-së i kishte dorëzuar dy propozime, por nga Kuvendi është kërkuar që të deklarohej vetëm për rezolutën. Kryesuesi konstatoi se askush nuk kishte votuar për dhe se andaj propozimi nuk mund të përfshihej në rendin e ditës. Ai vazhdoi më tej duke i dhënë fjalën z. Jakup Krasniqi (PDK), i cili propozoi që pika rendit të ditës lidhur me raportin e punës së Agjencisë së Rregullatorit të Telekomunikacionit (ART) të shtyhej duke pohuar që sipas kryesuesi i ART-së duhet t’i raportojë një herë në vit Kuvendit lidhur me punën e Agjencisë, e jo Komisioni i Kuvendit. Në

⁵ Propozimet e grupit parlamentar të AAK-së për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe rezoluta për diasporën janë dorëzuar në Zyrën për Parashpresa më 4, përkatësisht 6 korrik. Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 26 korrik, i ka diskutuar propozimet e AAK-së dhe ka vendosur t’i shtyjë ato për një fazë të mëvonshme për t’u dhënë grupeve parlamentare më shumë kohë për një konsultim më të gjerë.

emër të LDK-së, z. Alush Gashi e mbështeti propozimin e z. Krasniqi, kështuqë Kryesuesi e ftoi Kuvendin të votojë propozimin e z. Krasniqi, i cili është miratuar me shumicë votash për. Z. Emrush Xhemajli (LPK) propozoi që pika e fundit të rendit të ditës të jetë propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës “siç ka qenë praktikë më herët.” Kryesuesi u përgjigj se pohimi i z. Xhemajli ishte në rregull dhe se “kjo nuk është bërë në disa seanca sepse ka qenë gati e pamundur që të saktësohet rendi i ditës për seancën tjetër, por mund të bisedohet për këtë.” Z. Xhevat Bislimi (PDK) deklaroi se Kuvendi Komunal i Vitisë/Vitina kishte votuar njëzëri kundër propozimit për formimin e komunës së Klllokotit/Klokot dhe propozoi që Kuvendi *urgjentisht* të diskutojë ofertën e Grupit Negociator lidhur me procesin e decentralizimit. Kryesuesi u përgjigj se procedura nuk e lejonte futjen e kësaj çështje në rendin e ditës së seancës në fjalë dhe se Kryesia dhe Kuvendi duhej ta diskutonin këtë çështje. Kryesuesi atëherë e ftoi Kuvendin që ta votonte rendin e ditës së seancës plenare në fjalë, i cili është miratuar me shumicë votash për.

Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia e përgatit një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës së Kuvendit dhe menjëherë e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare, apo gjashtë (6) deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hudhet në votim.” Andaj, propozimi i Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion i parashtruar me shkrim më herët, është bërë në pajtim me rregullat e reja. Grupet parlamentare të LDK-së dhe PDK-së kanë bërë propozime gojore në pajtim me rregullën e mëparshme,⁶ e cila nuk është më në fuqi, dhe që lejonte që amendamentet në rendin e ditës të propozohen gojarisht.

Sipas rregullës 6.5, Kryesia “siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes, për të cilën çështje vendos Kuvendi.” Në mënyrë që Kuvendi të mund të marrë vendim, është e këshillueshme që materialet për të dy propozimet e grupit parlamentar të AAK-së t’i shpërndahen të gjithë deputetëve para seancës plenare.

Rregullat e reja 23.1-2 kërkojnë që rendi i ditës të miratohet në fillim të seancës plenare në fjalë. Pohimet e z. Xhemajli dhe të Kryesuesit ishin të bazuar gabimisht në rregullën e mëparshme 23.1, e cila kërkonte që rendi i ditës të miratohej nga Kuvendi në fund të seancës paraprake.

Rregulla 29.1 parasheh që “në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t’i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim.” Z. Bislimi ka kërkuar që ajo pikë e punës të diskutohet urgjentisht, por nuk ka kërkuar në mënyrë të qartë që të diskutohet në atë seancë plenare. Nëse ai ka pasur për qëllim që ta propozojë diskutimin pikërisht për atë ditë, atëherë së pari është dashur ta ketë edhe pajtimin e Kryesuesit. Sipas rregullës 29.1, Kryesuesi e ka lirinë për të përcaktuar nëse një çështje “e meriton ose jo vëmendjen e menjëhershme të Kuvendit.”

Mocionet procedurale

- Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik e ka diskutuar mocionin e parashtruar nga Emrush Xhemajli (LPK) më 23 qershor, në të cilin pohonte se të drejtat e tij të parapara me rregullat 30.1 (b) dhe 30.2 janë shkelur në seancën plenare të 15 qershorit meqë atij i është lejuar të fliste vetëm një minutë dhe propozimi i tij për ndërprerjen e punimeve të seancës plenare të 15 qershorit nuk është vënë në votim. Z. Nazim Jashari (ORA) dhe Hydajet Hyseni (PDK) kryesuesi i komisionit, deklaruan se veprimi i

⁶ Rregulla e mëparshme 23.1 parashihte që “në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose . . . gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.”

Kryesuesit në këtë rast përbën shkëlje të Rregullores së punës. Z. Sadudin Berisha (LDK) propozoi që komisioni ta shikojë transkriptin e seancës së 15 qershorit para se t'i paraqisnin rekomandim Kuvendit për këtë çështje. Anëtarët e tjerë të komisionit u pajtuan me propozimin e z. Berisha, kështu që komisioni vendosi ta shtyjë diskutimin e mocionit për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që në ndërkohë të shikohet transkripti.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik, e ka shqyrtuar mocionin e z. Xhemajli përsëri dhe nuk ka mundur të pajtohet lidhur me rekomandimin që duhet t'i ofrohet Kuvendit, andaj ka vendosur që ta shtyjë këtë çështje dhe të kërkojë nga administrata inçizimin e seancës plenare të 15 qershorit.

Rregulla 30.8 parasheh që “mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës dhe mocionin për shkëljen e të drejtave të deputetit, mund t'i bëjë, madje, vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.” Tri seanca plenare kanë kaluar që nga koha kur z. Xhemajli e ka parashtruar mocionin e tij më 23 qershor, por Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ende nuk e ka paraqitur rekomandimin e tij në Kuvend.⁷

Debatet

- Kryesia, në mbledhjet e saj më 6 dhe 11 korrik, është takuar me shefat e grupeve parlamentare për ta planifikuar rendin e ditës së seancës plenare të 13, 14 dhe 17 korrikut dhe është pajtuar që ta kufizojë kohën e debatit për raportin 100 ditor të Qeverisë në dy orë, duke e ndarë kohën proporcionalisht në mes të grupeve parlamentare.

Në fillim të seancës plenare më 13 korrik, pasi që Kryetari i Kuvendit e kishte paraqitur rendin e ditës, z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se kohëzgjatja e debatit të raportit 100 ditor të punës së Qeverisë nuk duhet të kufizohet. Z. Nazim Jashari (ORA) e mbështeti deklaratën e z. Krasniqi duke shtuar se sipas Rregullores së punës secilit deputet të Kuvendit i lejohet të flasë deri në dhjetë minuta. Kryetari i Kuvendit propozoi që Kuvendi të vazhdonte me rendin e ditës dhe ta diskutonte kohëzgjatjen e debatit në fjalë kur të arrinte te kjo pikë e rendit të ditës. Z. Sabit Rrahmani (Për Integrim) deklaroi se ai e mbështeste propozimin e PDK-së dhe ORA-s për moskufizimin e kohës së debatit. Z. Hajredin Kuçi (PDK) kërkoi nga Kryetari i Kuvendit që në pajtim me Rregulloren e punës, propozimin e PDK-së ta hudhë në votim. Z. Alush Gashi (LDK) dhe Naim Maloku (AAK) deklaruan se në dy mbledhjet e fundit të Kryesisë të gjitha grupet parlamentare ishin pajtuar që kohëzgjatja e debatit të kufizohet në dy orë, duke e ndarë kohën proporcionalisht në mes të grupeve parlamentare, dhe se prandaj marrëveshja duhej të respektohej. Z. Krasniqi deklaroi se ishte e vërtetë se Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare ishin pajtuar që ta kufizonin debatin në dy orë, por ai pohoi se marrëveshja nuk ishte në pajtim me Rregulloren e punës. Disa deputetë të tjerë nga opozita insistuan që të mos kishte kufizim kohor të debatit. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin për kufizimin e kohës së debatit në dy orë, i cili është miratuar me 47 vota për dhe 42 vota kundër. Në atë moment grupet parlamentare të PDK-së, ORA-s dhe grupit Për Integrim e lëshuan seancën. Kuvendi vazhdoi me pikën e radhës të rendit të ditës pas së cilës Kryetari i Kuvendit thirri një pushim në mënyrë që Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare të mirreshin vesh se si të vazhdohej më tutje me seancën.⁸ Pas pauzës, grupi parlamentar ORA dhe ai Për Integrim u kthyen në seancë dhe Kryetari i Kuvendit njoftoi se Kuvendi do të procedonte me rendin e ditës deri te pika për raportin 100 ditor të punës së Qeverisë dhe se do të vazhdonte ditën e nesërme, me ç'rast Kuvendi do të vendoste rreth kufizimit kohor të debatit për çështjen në fjalë.

Në fillim të vazhdimin të seancës më 14 korrik, Kryetari i Kuvendit njoftoi se shefat e grupeve parlamentare ishin takuar para fillimit të seancës atë ditë dhe ishin pajtuar që secili deputet të fliste deri në dhjetë minuta gjatë debatit për raportin 100 ditor të Qeverisë.

⁷ Për më shumë detaje, shiko raportin 04/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

⁸ Për më shumë detaje, shiko më poshtë pjesën e titulluar “Procesi i votimit”.

Mbledhjet e Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare për ta planifikur debatin e radhës, të mbajtura më 6 dhe 11 korrik, janë në pajtim të plotë me Rregulloren e punës dhe paraqesin përmirësim në krahasim me periudhat e mëparshme raportuese, kur kishte fare pak konsultime në mes të Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare. Konsultimet e rregullta me shefat e grupeve parlamentare parashihen në rregullën 6.2 dhe 23.3.⁹ Sipas rregullës 22.7, “diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se 10 (dhjetë) minuta për secilin deputet të Kuvendit, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe.” Megjithatë, rregulla 6.2 i jep të drejtë Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare që të pajtohen lidhur me kohëzgjatjen e debatit lidhur me një pikë të caktuar të punës. Në mënyrë që një marrëveshje e tillë të jetë e zbatueshme, shefat e grupeve parlamentare do të duhej të siguronin gjithashtu mbështetjen e anëtarëve të grupeve të tyre parlamentare.

- Në seancën plenare më 14 korrik, Kryeministri Agim Çeku bëri paraqitjen e raportit të punës 100 ditore të Qeverisë, që është pasuar me debat plenar në të cilin anëtarët e koalicionit e lavdëruan punën e Qeverisë, ndërsa anëtarët e opozitës ndër të tjera e kritikuan Qeverinë për zbatim të ngadalshëm të standardeve, për shkelje të ligjeve, nepotizëm, korrupsion dhe dështim në shpërbërjen e strukturave paralele. Gjatë debatit z. Xhevat Bislimi (PDK) e arriti kufizimin kohor prej dhjetë minutash por kryesuesi i lejoi që ta vazhdojë deklaratën e tij. Z. Bislimi e kritikoi Qeverinë për zbatimin e një politike anti-kosovare lidhur me trashëgiminë kulturore duke deklaruar se “Qeveria po vendos mina nëpër Kosovë” dhe duke pyetur në mënyrë retorike se “çka do të ndodhte sikur qindra xhami turko-arabe apo dhjetëra kisha romake të kërkonin zona speciale?” Ai e paralajmëroi Qeverinë “të mendonte seriozisht për braktisjen e kësaj praktike anti-kosovare.” Ai vazhdoi më tej duke thënë se “Kryeministri publikisht i ka mashtruar kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë duke e nënshkruar Ligjin për të drejtat e veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve të luftës së UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës me ndryshimet e UNMIK-ut¹⁰ andaj duhet të japë dorëheqje.” Në atë moment, kryesuesi ia çkyqi mikrofonin z. Bislimi duke deklaruar se e kishte keqpërdorur foltoren dhe i kishte “torturuar” kolegët e tij për 15 minuta.

Në fillim të seancës më 17 korrik, z. Bislimi bëri vërejtje në atë se anëtarët e Kryesisë nga koalicioni qeverisës nuk duhet ta keqpërdorin “karrigen e Kryetarit” për të vlerësuar deklaratat e deputetëve dhe, nëse dëshirojnë të bëjnë vlerësime, atëherë duhet ta bëjnë këtë nga foltorja që përdoret nga deputetët. Kryesuesi, z. Naim Maloku (AAK) zbriti poshtë dhe foli nga foltorja duke thënë: “Më lejoni t’i them edhe z. Bislimi edhe opozitës që më kot mundoheni të instaloni në këtë Kuvend zhargonin e rrugëve, zhargonin me fyerje, sharje dhe të pavërteta, sepse ne nuk jemi partner për një zhargon të tillë, por për dialog konstruktiv.” Ai më tutje deklaroi se z. Bislimi e ka keqpërdorur foltoren kur ka folur më 14 korrik. Në përgjigje të deklaratës së kryesuesit, z. Nazim Jashari (ORA) bëri vërejtje në emër të ORA-s në atë se kryesuesi e kishte akuzuar tërë opozitën për fyerje dhe gjuhë rruge, dhe e ftoi kryesuesin që në të ardhmen të jetë më konkret në komentimin e deklaratave. Z. Bislimi kundërshoi duke thënë se askush nuk kishte dëgjuar asnjë fyerje apo sharje në Kuvend dhe kërkoi nga kryesuesi që t’i kërkonte falje opozitës ose të tërhiqej nga kryesimi i mëtutjeshëm i seancës. Disa deputetë të tjerë të PDK-së protestuan ndaj deklaratës së kryesuesit dhe kërkuan nga ai që të kërkonte falje. Kryesuesi foli përsëri nga foltorja duke u arsyetuar se ka folur në cilësinë e deputetit, e jo të kryesuesit, me qëllim që ta shpjegonte ndërhyrjen e tij në deklaratën e z. Bislimi gjatë debatit më 14 korrik. Ai shtoi se nuk e kishte pasur për qëllim që ta fyente askend dhe propozoi që seanca të vazhdonte. Z. Hajredin

⁹ Rregulla 6.2: “Kryesia është përgjegjëse për programin e punës të Kuvendit. Ajo rishikon dhe përgatit rendin e ditës të mbledhjes së radhës të Kuvendit dhe merr pëlqimin nga grupet parlamentare për formën dhe për kohëzgjatjen e diskutimit për një çështje të caktuar të punës.”

Rregulla 23.3: “Kryesia konsultohet me kryetarët e grupeve parlamentare për caktimin e rendit të ditës të seancave të Kuvendit.”

¹⁰ Sipas rregullores (2006/29), emri zyrtar është “Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të konfliktit të armatosur në Kosovë”. Me qëllim të thjeshtësimit, dhe për shkak se përshkrimi reflekton diskutimin që është bërë në Kuvend, ky raport do t’i referohet këtij ligji si Ligji për të drejtat e veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve luftës së UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës.

Kuçi (PDK) dhe z. Ramë Buja (PDK) deklaruan se nëse kryesuesi nuk kërkonte falje, PDK-ja do ta lëshonte seancën. Kryesuesi, duke folur përsëri nga foltorja, deklaroi se “nëse ndokush është ndier i fyer atëherë unë kërkoi falje,” dhe propozoi përsëri që seanca të vazhdonte. Z. Jakup Krasniqi (PDK) kërkoi një pushim të shkurtër, i cili u dha. Pas pushimit, z. Krasniqi deklaroi se kryesuesi ka ofruar “gjysëm falje, por PDK-ja do ta konsiderojë si të plotë,” dhe se kryesuesi duhet të vendoste vetë nëse do të vazhdonte ta kryesonte seancën. Nuk pati debat të mëtutjeshëm për këtë gjë dhe kryesuesi vazhdoi me pikën e radhës të rendit të ditës.

Sipas rregullës 22.7 “nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe, diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se dhjetë (10) minuta për secilin deputet.” Sipas rregullës 22.9 Kryetari i Kuvendit mund t’i lejojë deputetit të flasë më tepër se koha në dispozicion nëse “konstaton se është në të mirë të diskutimit.” Andaj, ishte e drejtë e Kryesuesit që z. Bislimi t’i lejojë të flasë më gjatë se 10 minuta.

Rregulla 22.10 parasheh që deputetët e Kuvendit nuk duhet të përdorin gjuhë joparlamentare, e cila definohet si “ofenduese, shpifëse, apo kërcënuese; përdoret për sulme ose për fyerje personale; është gjuhë e pahijshme; apo që nxit dhunë ndëretnike.” Rregulla 22.11 parasheh që kryesuesi mund ta urdhërojë një deputet, i cili sipas mendimit të tij ka përdorur gjuhë joparlamentare, t’i tërheqë fjalët e tilla. Andaj, sipas rregullës 22.11, nëse kryesuesi mendon që një deputet i Kuvendit ka përdorur gjuhë joparlamentare, atëherë ai mund t’ia tërheqë vërejtjen atij deputeti të caktuar dhe jo tërë grupit parlamentar, të cilit i përket deputeti, apo opozitës në tërësi, siç është rasti në fjalë.

- Gjatë diskutimit të raportit të Kryesisë për Qendrën administrativo-protokollare në parkun e Gërmisë,¹¹ si përgjigje ndaj një deputeti i cili i ishte referuar z. Edi Rama¹² si shembull i mirë i një politikani i cili i mbron parqet, z. Fetah Berisha (LDK) deklaroi se “z. Edi Rama nuk duhet të mirret shembull në këtë Kuvend, sepse ai është sinonim i së keqes.” Kryetari i Kuvendit kërkoi nga ai që t’i tërheqë fjalët që e kualifikonin z. Rama, por z. Berisha kundërshtoi duke thënë se ka të drejtën e mendimit të vetë. Atëherë, Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai ka të drejtën e mendimit të tij, por “jo ta shprehë në atë mënyrë”. Z. Berisha nuk i tërhoqi fjalët e tij. *Ndërhyrja e Kryetarit të Kuvendit gjatë fjalës së z. Berisha është në pajtim me rregullën 22.11 e cila parasheh që Kryetari i Kuvendit mund ta urdhërojë cilindo deputet i cili, sipas mendimit të tij, ka përdorur “gjuhë joparlamentare”, e cila ndër të tjera definohet si “sulum ose fyerje personale”, t’i tërheqë fjalët e tilla. Rregulla 22.12 gjithashtu parasheh që “deputeti . . . është i detyruar t’i respektojë urdhërat e Kryetarit të Kuvendit për sjelljen për të cilën atij tashmë i është tërhequr vërejtja.” Z. Berisha nuk ka vepruar në përputhje me rregullat.*

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për trashëgiminë kulturore; projektligji për ndryshimin e Ligjit 2004/5 mbi tregtinë me naftë dhe produkte të naftës; projektligji për zonat e lira industriale; dhe projektligji për parqet nacionale janë shpërndarë më 5 korrik. Prandaj, projektligjet janë shpërndarë pesëmbëdhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 27 korrik. *Rregulla 35.1, parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Kjo paraqet një përmirësim në krahasim me periudhat e mëparshme raportuese, kur shumica e projektligjeve shqyrtoheshin për herë të parë pas më shumë se tri javësh pas dorëzimit të tyre.*

¹¹ Raporti i Kryesisë për Qendrën administrativo-protokollare në parkun e Gërmisë përfshin tre konstatime dhe katër rekomandime. Konstatimet parashohin ndër të tjera se “(1) . . . nuk ka pasur vendim valid për ndërtimin e Qendrës, (2) . . . gjatë procesit të tenderimit ka pasur konflikt interesi, dhe (3) *Aneksi C nuk i është nënshtruar votimit në Kuvend*”. Kryesia, në raportin e saj, megjithatë ka rekomanduar që “(1) ndërtimi i Qendrës në Gërmi të vazhdojë; (2) të bëhet një vlerësim për mjetet shtesë të nevojshme për aneksin C; (3) mbikqyrësi i projektit të zëvendësohet, dhe (4) parregullsitë në rrugën e realizimit të këtij projekti mbeten çështje e auditimit të jashtëm.”

¹² Kryebashkiak i Tiranës dhe kryetar i partisë socialiste të Shqipërisë (PS), partisë më të madhe opozitare në Kuvendin e Shqipërisë.

Procesi i votimit

- Në seancën plenare të 13, 14 dhe 17 korrikut, pasi që Kuvendi kishte votuar për kufizimin kohor të debatit mbi raportin e punës 100 ditore të Qeverisë, grupet parlamentare të PDK-së, ORA-s dhe Për Integrim dolën nga salla plenare duke e lënë seancën plenare pa kuorum, por me më shumë se dyzet deputetë të pranishëm. Kryetari i Kuvendit njoftoi se kishte numër të mjaftueshëm të deputetëve për të vazhduar punën, por propozoi që të bëhej një pushim në mënyrë që shefat e grupeve parlamentare të arrinin marrëveshje për kthimin e opozitës në seancë. Në atë moment disa deputetë zëshëm e kundërshtuan propozimin për pushim dhe kërkuan që seanca të vazhdoj. Andaj, Kryetari i Kuvendit vazhdoi me pikën e radhës së rendit të ditës “Pyetjet për Qeverinë”, e cila nuk kërkonte votim. Pika e radhës e rendit të ditës ishte shqyrtimi i dytë i projektligjit për liritë fetare dhe statusin juridik të bashkësive fetare, por Kryetari i Kuvendit e thirri një pushim meqë nuk kishte kuorum për t’i votuar amendamentet. Pas pushimit, grupet parlamentare të ORA-s dhe Për Integrim u kthyen në sallë, dhe Kryetari i Kuvendit lajmëroi se të pranishëm ishin 62 deputetë, andaj seanca mund të vazhdonte. Më vonë gjatë seancës, Kryetari i Kuvendit kishte vërejtur se numri i deputetëve të pranishëm kishte rënë nën 61 dhe i ftoi deputetët të ktheheshin në sallën plenare. Votimi filloi vetëm pas arritjes së kuorumit. Numri i deputetëve të pranishëm në sallë nuk kishte rënë nën dyzet asnjëherë gjatë seancës plenare në fjalë. Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancat plenare në fjalë.

Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1-2, të cilat parashohin që “shumica e deputetëve Kuvendit përbën kuorumin. Kuvendi mund të fillojë dhe të vazhdojë punimet kur janë të pranishëm të paktën një e treta e deputetëve, me kusht që për marrjen e vendimeve të përmbushet kushti për kuorum”.

- Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për përdorimin e gjuhëve, në seancën plenare të 27-28 korrikut, kur Kuvendi po përgatitej për të votuar amendamentin në nenin 22.3, z. Mazllom Kumnova (AAK) deklaroi se Komisioni për buxhet i kishte dorëzuar një amendament komisionit funksional për fshirjen e nenit 22 në tërësi,¹³ por që nuk ishte përfshirë në radhitjen e amandamenteve për t’u votuar nga Kuvendi. Ai pohoi se neni në fjalë ka implikime financiare të jashtëzakonshme dhe se “ndërhyn dhunshëm” në sistemin arsimor dhe propozoi fshirjen e nenit 22 nga projektligji. Znj. Nekibe Kelmendi (LDK) kryesuese e komisionit funksional (Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media) deklaroi se komisioni i saj e kishte diskutuar nenin 22 gjatë pushimit dhe ishte pajtuar me konsensus që neni të mos fshihej në tërësi, por që në vend të kësaj neni 22.1 të ndryshohej ashtuqë të ishte si në vijim “Në shkollat fillore, mundësohet mësimi i gjuhës së dytë zyrtare si pjesë e *planprogramit opsional*” në vend se të jetë *lëndë e detyrueshme* siç parashihej në dispozitën në fjalë. Z. Hydajet Hyseni (PDK) propozoi që shqyrtimi i dytë i projektligjit në fjalë të ndërpritej për momentin dhe të shtyhej në mënyrë që t’u mundësohej komisionit funksional dhe Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport që t’i harmonizojnë qëndrimet lidhur me nenin 22. Z. Behxhet Brajshori (LDK) propozoi që të bëhej një pushim i shkurtër në mënyrë që komisioni funksional dhe Komisioni për buxhet të arrijnë një marrëveshje lidhur me nenin në fjalë. Z. Nazim Jashari (ORA), z. Jakup Krasniqi (PDK), z. Naser Osmani (LDK, kryesues i komisionit për buxhet) dhe z. Alush Gashi (LDK) e mbështetën propozimin e z. Kumnova që neni 22 të fshihej në tërësi. Andaj, Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e z. Kumnova, i cili është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër. Kuvendi vazhdoi më tutje me shqyrtimin e dytë.

Raporti i Komisionit për buxhet për projektligjin në fjalë, që i është dorëzuar komisionit funksional dhe që i është bashkangjitur radhitjes së amandamenteve, nuk përfshinte amendamentin e lartpërmendur për fshirjen e nenit 22. Rregulla 6.3 parasheh që “ftesa me rend dite dhe materialet për shqyrtim u dërgohen deputetëve së paku tri ditë pune para seancës

¹³ Neni 22 i projektligjit për përdorimin e gjuhëve shkruan: “(22.1) Në shkollat fillore, në plotësim të gjuhës së mësimi, çdo person do të mësojë gjuhën e dytë zyrtare; (22.2) Në shkollat e mesme, në plotësim të gjuhës së mësimi, mundësohet mësimi i gjuhës së dytë zyrtare si pjesë e *planprogramit opsional*. Nxënësit së bashku me prindërit e tyre kanë të drejtën për të zgjedhur mësimin e gjuhës së dytë zyrtare; (22.3) Planprogrami për mësimin e gjuhëve zyrtare zhvillohet nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë.”

plenare.” Andaj, çdo amendament që duhet të votohet në Kuvend në shqyrtim të dytë duhet të përfshihet në radhitjen e amendamenteve, në vend se të propozohet aty për aty në mes të shqyrtimit të dytë të projektligjit, sikur në rastin e lartshënuar.

Emërimi i anëtarit të pestë të Këshillit të KPM-së

- Gjatë seancës plenare më 13 korrik, Kryetari i Kuvendit njoftoi se Kryesia në bashkëpunim me OSBE-në e kishte hartuar Rregulloren për emërimin e anëtarit të pestë të Këshillit të KPM-së, dhe e hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Asnjëri nga deputetët nuk u paraqit për fjalë, prandaj Kryetari i Kuvendit e vëri në votim projektregulloren, e cila është miratuar me 57 vota për dhe tri vota kundër.

Në seancën plenare të 27-28 korrikut, Kryetari i Kuvendit i paraqiti propozimet e bëra nga grupet parlamentare për anëtarin e pestë – Adil Pireva (LDK), Ekrem Kryeziu (PDK), Vjosa Shala-Pallaska (AAK), dhe Maksut Shehu (ORA) – dhe kërkoi nga stafi i administratës që t’i përgatiste fletëvotimet për votim të fshehtë. Në atë moment, z. Džezair Murati (6+/Vakat) e kërkoi fjalën dhe bëri vërejtje në këtë pikë të rendit të ditës, duke pohuar se Kuvendi e kishte miratuar një amendament në Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), gjatë shqyrtimit të tij të dytë, sipas së cilit një nga pesë anëtarët vendor të Këshillit të KPM-së do të ishte përfaqësues nga radhët e një komuniteti joshqiptar dhe joserb, por që “ky amendament kishte humbur diku rrugës në mes të Kuvendit dhe zyrës ligjore të UNMIK-ut”. Ai pohoi se Kuvendi kishte marrë një vendim të padrejtë, dhe se grupi 6+ nuk do të vazhdonte të merrte pjesë në seancë meqë po shkilen të drejtat e tyre. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se sipas interpretimit të zyrës ligjore të UNMIK-ut, të gjitha kushtet e parapara në Ligjin në fjalë ishin plotësuar, dhe se nuk kishte më pengesa për të vazhduar me përzgjedhjen e anëtarit të pestë atë ditë. Ai më tutje shtoi se grupi 6+ ka pasur të drejtë për të propozuar kandidatin e tyre, por se nuk e kishte bërë. Z. Murati dhe dy deputetë të tjerë të partisë së tij më pas dolën nga salla plenare. Kryetari i Kuvendit lajmëroi se emërimi i anëtarit të pestë kërkonte vetëm shumicën e thjeshtë, dhe Kuvendi vazhdoi me votimin e fshehtë të propozimeve. Rezultati i votimit ishte si në vijim: Z. Pireva – 42 vota, z. Kryeziu – 23 vota, z. Shala-Pallaska – shtatë vota, z. Shehu – katër vota, dhe tri fletëvotime janë shpallur si të “pavlefshme”, me gjasë abstenimet. Me emërimin e z. Adil Pireva, Kuvendi e ka përmbyllur ratifikimin e emërimit të të pesë anëtarëve vendor të Këshillit të KPM-së.

Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për KPM-në më 21 prill 2005, Kuvendi ka miratuar një amendament në nenin 4.1 të propozuar nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, i cili parashihte që “njëri prej pesë anëtarëve vendor të Këshillit të KPM-së do të jetë nga komuniteti joshqiptar dhe joserb.” Por, më vonë, dispozita e njëjtë është ndryshuar në Rregulloren (2005/34) me të cilën është shpallur ligji dhe parasheh që “përbërja e anëtarëve të këshillit që janë banorë të Kosovës duhet të pasqyrojë parimin e multi-etnicitetit.” Katër anëtarët e shoqërisë civile të Këshillit të KPM-së, të emëruar nga Kuvendi më 27 prill 2006, përfshijnë dy femra, njëra prej të cilave është serbe e Kosovës. Në letrën e zyrës ligjore të UNMIK-ut të datës 10 maj 2006, dërguar Kryetarit të Kuvendit si përgjigje ndaj kërkesës së Kuvendit për interpretim ligjor të dispozitave përkatëse të Ligjit për KPM-në, thuhet se “në pritje të emërimit të anëtarit të pestë, dy prej pesë anëtarëve vendor janë femra dhe një është prej komunitetit joshumicë, kështuqë kjo përmbush të dy kërkesat, përfaqësimin gjinor dhe parimin e multietnicitetit. Ligji nuk e kërkon e as nuk e parandalon emërimin e anëtarit plotësues nga komuniteti jo-shumicë për të plotësuar postin përfundimtar. Prandaj, Kuvendi ka diskrecion të plotë në këtë çështje.” Rregullorja për emërimin e anëtarit të pestë, e miratuar më vonë nga Kuvendi, i mundësonte secilit grup parlamentar të propozojë kandidatin e vetë. Grupi parlamentar 6+ kishte të drejtë për të propozuar kandidatin e vetë për anëtarin e pestë, por nuk e ka bërë këtë.

Emërimi i zëvendësministrave

- Kryesia, më 26 qershor, i ka dërguar zyrës ligjore të UNMIK-ut një kërkesë për interpretim ligjor të rregulloreve të UNMIK-ut të cilat janë relevante për emërimin e zëvendësministrave,

për shkak të një debati të vazhdueshëm në Kuvend lidhur me atë nëse zëvendësministrat duhet të emërohen apo jo nga Kuvendi.¹⁴ Zyra ligjore e UNMIK-ut, më 5 korrik, i ka kthyer interpretimin ligjor të kërkuar Kryetarit të Kuvendit, me shpjegimin se sipas nenit 1.2.1 të rregullores së UNMIK-ut 2005/15, zëvendësministrat duhet të emërohen nga Kuvendi. Duke iu referuar zëvendësministrit të drejtësisë, emërimi i të cilit ishte në pritje e sipër në Kuvend për shkak të arsyeve të lartpërmendura, letra e zyrës ligjore të UNMIK-ut shpjegonte se për emërimin e zëvendësministrit nevojitej vetëm shumica e thjeshtë e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Pas interpretimit të zyrës ligjore të UNMIK-ut, Kuvendi, më 28 korrik, e ka emëruar zëvendësministrin e drejtësisë, z. Altay Suroy, me 34 vota për dhe 32 vota kundër.

Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 13, 14 dhe 17 korrikut, opozita ka dalur nga salla plenare para se të arrihej te pika e rendit të ditës “Pyetjet për Qeverinë”, kështuqë Ministrat janë përgjigjur vetëm në shtatë prej dymbëdhjetë pyetjeve. Andaj, pesë pyetjet e mbetura që ishin dorëzuar nga opozita janë ricaktuar për seancën plenare të radhës. Në seancën plenare të 27-28 korrikut, pesë nga njëmbëdhjetë pyetje morën përgjigje. Kryesuesi e informoi Kuvendin se pyetjet që nuk kishin marrë përgjigje do të përsëriten në seancën plenare të radhës. Gjatë seancës plenare të 27-28 korrikut, z. Agim Krasniqi (LDK) paraqiti vërejtjen se një numër i madh i pyetjeve po parashtroheshin për çdo seancë, dhe propozoi që pyetjet në çdo seancë të marrin përgjigje me shkrim në vend të përgjigjes me gojë. Kryesuesi u përgjigj se periudha e pyetjeve po bëhej në pajtim me rregullën e re të miratuar kohëve të fundit nga Kuvendi, sipas të cilës, periudhës së pyetjeve për Qeverinë duhet t’i dedikohen deri në 50 minuta në çdo seancë plenare. Në seancën e njëjtë, z. Hydajet Hyseni (PDK) përmendi se e kishte dorëzuar një pyetje për Ministrin e Pushtetit Lokal para shumë kohe,¹⁵ e cila ende nuk kishte marrë përgjigje, dhe insistoi në marrjen e përgjigjes. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletinin e Kuvendit.¹⁶

Periudha e pyetjeve është kryer në pajtim me rregullën e re 26 mbi “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë”, që parasheh se rendi i ditës i çdo seance plenare përfshin një periudhë kohore deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë jipet për pyetjen e deputetit, tre minuta për përgjigjen e Ministrit, një minutë për pyetjen shtesë, dhe dy minuta për përgjigje në pyetjen shtesë.

Z. Hyseni së pari e kishte dorëzuar pyetjen e tij më 8 gusht 2005, kur rregulla e mëparshme 26 mbi pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë ishte në fuqi.¹⁷ Më 13 qershor, pas ndryshimit të rregullës 26 në seancën plenare të 1-2 qershorit 2006, z. Hyseni e ka parashtruar pyetjen e tij përsëri, e cila ishte planifikuar për seancën plenare të 15 qershorit, por nuk kishte marrë përgjigje. Sipas rregullës së re 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletin e Kuvendit për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve.” Kanë kaluar katër seanca plenare nga koha kur z. Hyseni e ka përsëritur pyetjen e tij, dhe nuk ka marrë përgjigje. Poashtu, buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Gjatë diskutimit të raportit për punën 100 ditore të Qeverisë në seancën plenare të 13, 14 dhe 17 korrikut, z. Mahir Yagcilar (6+/KDTP) bëri vërejtje në atë se përfaqësuesit e komuniteteve pakicë nuk janë të përfshirë në grupet punuese të Qeverisë që bëjnë hartimin e projektligjeve dhe theksoi se shpresonte që kjo do të përmirësohej.

¹⁴ Për më shumë detaje, shiko raportin 04/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

¹⁵ Pyetja e z. Hyseni është në lidhje me keqpërdorimin e supozuar të mjeteve të ndara nga Qeveria për komunën e Gjilanit/Gnjilane, si ndihmë pas tërmetit në këtë komunë.

¹⁶ Kryetari i Kuvendit e mori kryesimin e seancës së 27-28 korrikut nga kryesuesi z. Sabri Hamiti, kah fundi i pikës së rendit të ditës “Pyetjet për Qeverinë.”

¹⁷ Shiko pjesën e titulluar “Pyetjet për Qeverinë” të raportit 03/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

Vërejtje të ngjashme janë bërë në disa raste në Kuvend.¹⁸ Më 8 prill 2005, Kryeministri ka nxjerrë një “Vendim për përfshirjen e ekspertëve në grupet punuese për hartimin dhe vlerësimin e projektligjeve,” i cili parasheh që sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit duhet t’i përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve minoritare në grupet punuese për hartimin e projektligjeve që janë “të rëndësishme për minoritetet kombëtare apo interesat e tyre” por nuk është e qartë nga teksti se mbi çfarë baze përcaktohet se cilat projektligje janë të rëndësishme për interesat e komuniteteve.¹⁹

Mocionet kundër ligjeve të miratuara mbi bazën e ndikimit të tyre në interesat vitale të komuniteteve

- Më 14 korrik, Grupi për Integrim e ka parashtruar një mocion kundër Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, të miratuar nga Kuvendi një ditë më parë. Grupi Për Integrim në mocionin e tij ka pohuar se:

“Vendimi i Kuvendit të Kosovës për votimin e amandamentit gjashtë (6) në projektligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, të propozuar nga Komisioni parlamentar për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, me të cilin përcaktohet mundësia e ndërprerjes elektive e shtatzënisë deri në fund të javës së dymbëdhjetë (12), është në kundërshtim të plotë me nenin 107 të Ligjit për shëndetësinë, i cili në mënyrë decisive e ndalon ndërprerjen e shtatzënisë pas javës së dhjetë (10). Me këtë janë cënuar interesat jetike të qytetarëve dhe të komuniteteve të përfaqësuara nga grupi parlamentar “Për Integrim”, meqë kemi të bëjmë me dispozita ligjore të cilat në tërësi janë kundërtënëse njëra me tjetrën. Kjo i vë qytetarët të cilët i përfaqësojmë në pozitë të pabarabartë para ligjit.”

Më 19 korrik, Kryesia e ka shqyrtuar mocionin e Grupit për Integrim dhe ia ka përcjellur Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, si sponsorues i dispozitës në fjalë. Më 28 korrik, komisioni e ka dorëzuar përgjigjen e tij me konkludimin se “(a) komisioni dhe Grupi për Integrim nuk kanë arritur konsensus për mocionin, dhe (b) komisioni e mbështet Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë ashtu siç është miratuar nga Kuvendi.” Kryesia do ta procedojë mocionin pasi të kryhet pushimi veror i Kuvendit.

- Më 28 korrik, grupi parlamentar 6+ ka dorëzuar një mocion kundër Ligjit për përdorimin e gjuhëve, të miratuar nga Kuvendi një ditë më parë. Grupi 6+ në mocionin e tij ka pohuar se:

“Ligji është në kundërshtim me nenet 1.1, 3.3 dhe 4.4 të Kornizës Kushtetuese, dhe nenin 9 të rregullores 2000/45 të UNMIK-ut. Duke pasur parasysh se regjistrimi i popullsisë dhe procesi i decentralizimit nuk janë zbatuar ende, ne konsiderojmë se dispozitat e miratuara i shkelin jo vetëm të drejtat e komunitetit turk të cilat janë respektuar në të kaluarën, por edhe të drejtat njerëzore dhe gjuhësore, si dhe interesat e shoqërisë sonë. Andaj, kërkojmë nga Kryesia që ta shqyrtojë këtë çështje.”

Në takimin e Kryesisë më 31 korrik, z. Mahir Yagcilar (6+/KDTP) njoftoi se grupi i tij parlamentar e ka dorëzuar mocionin dhe kërkoi të dinte se si do të procedohej nga Kryesia. Z. Sabri Hamiti (LDK) pyeti nëse mocioni mund të procedohej pas pushimit veror, duke shtuar se mbledhja e asaj dite e Kryesisë nuk ishte mbledhje e rregullt dhe se pushimi tashmë kishte filluar. Z. Xhavit Haliti (PDK) deklaroi se ai donte të dinte nëse Rregullorja i lejonte Kryesisë që ta procedonte mocionin pas pushimit, duke shtuar se ai nuk ishte për shkelje të Rregullores. Z. Yagcilar u pajtua që mocioni të procedohej pas kryerjes së pushimit. Pas marrjes së shpjegimeve procedurale lidhur me këtë çështje, Kryesia pa diskutime të metutjeshme ia ka përcjellur mocionin Qeverisë, si sponsoruese e Ligjit. Më 2 gusht, Qeveria e ka dorëzuar përgjigjen e saj në të cilën e fton Kryesinë që ta mbështesë mocionin e grupit parlamentar 6+.

Rregullat 40.1-2 të Rregullores së punës dhe nenet 9.1.39-40 të Kornizës Kushtetuese parashohin që “brenda dyzet e tetë orësh pas miratimit të ligjit nga Kuvendi . . . çdo deputet i Kuvendit, i

¹⁸ Shiko raportet 02/2004, 01/2005, 10/2005, 01/2006 dhe 02/2006 të shtYllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

¹⁹ Vendimi Nr. 041/2005, 08 prill 2005

mbështetur nga pesë ose më tepër deputetë, mund t'ia paraqesë Kryesisë një mocion, me pretendimin se ligji në fjalë, ose dispozitat specifike të tij, shkelin interesat vitale të komunitetit të cilit ai/ajo i përket. Kryesia kërkon nga propozuesi i ligjit ose dispozitave që si përgjigje të sigurojnë argumente të arsyeshme brenda tri ditësh.” Vendimi i Kryesisë që t'ia përcjellë mocionin e grupit 6+ Qeverisë, dhe mocionin e grupit Për Integrim komisionit funksional, si sponsorues i dispozitës përkatëse, është në pajtim me Rregulloren. Neni 9.1.41 parasheh që “pesë ditë pas marrjes së përgjigjes, Kryesia përpiqet t'i dorëzojë Kuvendit një propozim të bërë me koncensus,” por Kryesia ka vendosur që t'i procedojë mocionet pas pushimit veror të Kuvendit. Rregullorja e punës nuk përmban dispozitë që rregullon afatin kohor për procedimin e mocioneve të tilla derisa Kuvendi gjendet në pushim veror.

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, si dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Më 14 korrik, seanca plenare ka zgjatur më shumë, duke përfshirë edhe kohën e planifikuar për program normal të RTK-së. Andaj, pjesa e fundit e seancës plenare nuk është transmetuar drejtpërdrejtë, por më vonë atë mbrëmje.

Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.